



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
ANTI-KORRUPSIONIN DHE SUNDIMIN E LIGJIT PËR SHQIPËRINË 2030 NË
BASHKIMIN EUROPIAN”

RELACION PËR PROJEKTVENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT ANALITIK TË KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR “PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
ANTI-KORRUPSIONIN DHE SUNDIMIN E LIGJIT PËR SHQIPËRINË 2030 NË
BASHKIMIN EUROPIAN”

RELACION PËR PROJEKTVENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT ANALITIK TË KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR “PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
ANTIKORRUPSIONIN DHE SUNDIMIN E LIGJIT PËR SHQIPËRINË 2030 NË
BASHKIMIN EUROPIAN”

I. Qëllimi i projektaktit dhe objektivat që synohet të arrihen

Kuvendi i Shqipërisë, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Rregulloren e Kuvendit, në reflektim dhe zbatim të rekomandimeve të Komisionit Europian, të shprehura në raportet e progresit (2023, 2024), raportin *screening* për Grup-kapitullin I “Themeloret” (2023), raportit “Për shtetin e së drejtës” të Komisionit Europian (2024), si dhe në kuadër të vendimmarrjes së negociatave me Bashkimin Europian (BE) më datë 27 maj 2024 miratoi rezolutën “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”.

Në zbatim të kësaj rezolute Kuvendi, me vendimin nr. 50, datë 30.5.2024, vendosi ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian” dhe me vendimin nr. 53, datë 6.6.2024 vendosi përbërjen e anëtarëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Në kontekstin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë dhe nevojës së një angazhimi më të madh nga të gjithë aktorët, në përmbushje të kriterëve të negociatave, veçanërisht të Grup-kapitullit I “Themeloret”, Kuvendi vlerësoi se thellimi i ciklit të reformave në fushat e i) mirëqeverisjes, ii) antikorrupsionit dhe iii) sundimit të ligjit përbën një domosdoshmëri për zhvillimin e vendit me ritme më të shpejta për konsolidimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Thellimi i reformave në këto fusha gjithashtu jep garanci më të forta për procesin e negociatave, për një ritëm të lartë angazhimi në këtë proces si dhe për avancimin e mëtejshëm në përmbushje të piketave kryesore të negociatave për anëtarësimin e vendit në BE.

Për t’i dhënë një frymë dhe qasje të re thellimit të reformave shtetformuese në ushtrimin e prerogativave të tij kushtetuese, Kuvendi, me këtë komision të posaçëm parlamentar (KPP) synoi të ndërhyjë duke marrë një rol udhëheqës në drejtim të mirëqeverisjes, thellimit të luftës ndaj korrupsionit dhe sundimit të ligjit për të hartuar një plan masash dhe për të adresuar shumë më mirë përgjegjësitë e tij në përballjen me këto sfida kyç për të ardhmen e vendit. Kjo do të shërbejë për qeverisje më të mirë dhe më llogaridhënëse për qytetarët, për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, po ashtu do të ndihmojë në përshpejtimin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Komisioni i posaçëm parlamentar asistoi dhe mbështeti këtë proces, duke miratuar dokumentet e hartuara dhe të konsultuara nga GENL-ja.

KPP-ja, bazuar edhe në parashikimet e rezolutës dhe vendimit nr.50 të Kuvendit, e zhvilloi punën e tij në 3 faza kryesore, në të cilat u hartuan dhe miratuan edhe dokumentet përkatëse:

1. Hartimi dhe miratimi i Dokumentit Analitik, duke realizuar një analizë të thelluar të situatës aktuale në të tria shtyllat.
2. Hartimi dhe miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit, me kohështirje afatgjatë dhe të qëndrueshme dhe me masa e indikatorë konkretë për adresimin e sfidave përkatëse në

këto fusha, duke përcaktuar edhe mekanizmat për zbatimin, monitorimin e mbikëqyrjen e tyre.

3. Hartimi dhe propozimi i projektligjeve dhe masave/projekteve për ndryshime të mundshme institucionale, që do të dakordësohen mbi bazën e PKV-së.

Synimi i KPP-së për hartimin e Dokumentit Analitik është pasja e një dokumenti të parë shqiptar, që analizon me sens vetëkritik dhe reflektimi situatën në të gjitha dimensionet për të tria shtyllat, duke studiuar dhe analizuar kuadrin ligjor vendas dhe ndërkombëtar, dokumentet strategjike dhe angazhimet e shprehura nga shteti shqiptar, në kuadër të procesit të anëtarësimit europian, si dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, duke evidentuar, gjithashtu, edhe praktikat më të mira të vendeve europiane lidhur me zgjidhjet e sugjeruara dhe evidentimin e standardeve ndërkombëtare. Synimi kryesor i KPP-së, në mënyrë të veçantë, ka qenë që ky proces, veçanërisht dokumentet që janë hartuar së bashku me propozimet përkatëse, të jetë gjithashtu në përputhje të plotë me rekomandimet e BE-së dhe kriteret për pozicionet negociuese.

Qëllimi i Dokumentit Analitik është kryerja e një analize shumëdimensionale, objektive, transversale, të strukturuar dhe të thelluar mbi një qasje tematike, duke ofruar një vlerësim të kuadrit ligjor dhe institucional; evidentimi i arritjeve, sfidave, problematikave dhe gjetjeve e rekomandimeve në fushën e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit.

Ky dokument ka përfshirë të gjitha masat ligjore dhe institucionale të zbatuara deri tani, duke ofruar një panoramë gjithëpërfshirëse dhe duke shqyrtuar efektivitetin e tyre në bazë të gjetjeve nga raportet e monitorimit të brendshëm dhe ndërkombëtar, si dhe analizat e realizuara nga grupi i ekspertëve.

Aktet strategjike, të miratuara nga qeveria shqiptare, si dhe angazhimet e vendit tonë ndaj BE-së dhe udhërrëfyesit përkatës kanë shërbyer si pika kyçe reference për analizimin e situatës aktuale dhe rekomandimin e masave konkrete për adresimin e sfidave në të tria fushat, si: udhërrëfyesit “Për shtetin e së drejtës”, “Për funksionimin e institucioneve demokratike” dhe “Për reformën në administratën publike 2023-2030”, Agjenda Kombëtare e Reformave, Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe plani i saj i veprimit, si dhe Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 dhe plani i saj i veprimit. Gjithashtu, analiza ka përfshirë edhe planet e veprimit të Kuvendit për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian për vitin 2023 dhe vitin 2024, si dhe raportet vjetore të Kuvendit.

Dokumenti Analitik shërben si bazë substanciale dhe metodike për hartimin dhe implementimin e Planit Kombëtar të Veprimit, me kohështirje afatgjatë dhe të qëndrueshme për adresimin e sfidave përkatëse në të tria fushat, përfshirë edhe masat për ndryshime të mundshme ligjore dhe institucionale, që burojnë nga rekomandimet e Dokumentit Analitik.

Në këtë frymë KPP-ja u angazhua në misionin institucional dhe kushtetues për thellimin e reformave, në funksion të objektivit strategjik "Shqipëria 2030 në BE", me qëllim që, përmes një procesi multidimensional publik, gjithëpërfshirës, transparent, profesional dhe në reflektim të standardeve më të mira ndërkombëtare, si katër parimet kryesore bazë, mbështetur në mekanizmat, rregullat dhe procedurat përkatëse parlamentare, me angazhimin dhe kontributin aktiv të ekspertizës më të mirë vendase dhe ndërkombëtarë, të realizojë drejtimin dhe koordinimin e një procesi të thelluar të reformave në mirëqeverisje, luftën kundër korrupsionit dhe sundimin e ligjit.

II. Baza ligjore

Vlerësimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi vendas e ndërkombëtar

Dokumenti Analitik paraqitet me propozimin e grupit të deputetëve të Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit”, në mbështetje të nenit 77, pika 1; nenit 78 dhe nenit 80, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neneve 24 e vijues të Rregullores së Kuvendit. Ky dokument hartohet, gjithashtu, në zbatim të rezolutës së Kuvendit të datës 27.5.2024, vendimit nr. 50, datë 30.5.2024 dhe vendimit nr. 53, datë 6.6.2024.

Në përmbajtjen e tij Dokumenti Analitik nuk përbën akt me natyrë normative, në kuptimin që nuk prodhon detyrime juridike *stricto sensu* për subjektet e së drejtës. Megjithatë ai përfaqëson një analizë të thelluar, objektive, transversale dhe gjithëpërfshirëse të situatës aktuale në fushat e mirëqeverisjes, sundimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit, e cila ka shërbyer si bazë substanciale dhe metodologjike për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit.

Plani i ndërtuar mbi këtë analizë përmban një sërë rekomandimesh të strukturuar për ndërmarrjen e masave konkrete, me karakter ligjor dhe institucional, të cilat parashikohet të konkretizohen në vijim përmes akteve ligjore dhe nënligjore, në përputhje me procedurat kushtetuese dhe kuadrin normativ në fuqi. Për rrjedhojë Dokumenti Analitik përbën një instrument strategjik, i ndërtuar mbi analizën e legjislacionit ekzistues dhe evidentimin e vakumeve ligjore, duke ofruar kështu një themel të argumentuar për planifikimin e ndërhyrjeve reformuese.

Në kontekstin e së drejtës ndërkombëtare dhe të procesit të integritetit europian, ky dokument merr një vlerë imperative funksionale, pasi hartimi i tij synon adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të Bashkimit Europian, të pasqyruara në raportet vjetore të progresit dhe dokumentet e tjera të monitorimit, me qëllim përafrimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar me *acquis* dhe standardet e BE-së.

Në këtë kuptim Dokumenti Analitik përbën bazën analitike, konceptuale dhe orientuese mbi të cilën mbështetet hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit, duke i paraprirë fazës së konkretizimit normativ të masave të rekomanduara për avancimin e mëtejshëm të reformave institucionale dhe legjislative.

III. Vlerësimi i shkallës së përafrimit me *acquis*-në e Bashkimit Europian

Projektligji nuk synon përafrimin me ndonjë akt të *acquis* së BE-së, por është hartuar duke pasur si udhërrëfyes të tij angazhimet e shtetit shqiptar në kuadër të anëtarësimit në BE, veçanërisht detyrimet dhe rekomandimet që rrjedhin nga dokumenti i pozicionit negociues për Grup-kapitullin I “Themeloret”, raportprogreset e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2023 dhe vitin 2024, raporti i Komisionit Europian “Për shqyrtimin analitik të Grup-kapitullit I “Themeloret”” (raporti *screening*) për vitin 2023 dhe raporti i Komisionit Europian “Për shtetin e së drejtës” për vitin 2024 etj.

IV. Metodologjia dhe hapat e ndjekur për hartimin e Dokumentit Analitik

Në hartimin e këtij Dokumenti Analitik është ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, transparente, profesionale, duke iu përmbajtur standardeve të BE-së dhe atyre ndërkombëtare. Metodologjia e ndjekur për realizimin e Dokumentit Analitik është ndërtuar mbi një qasje cilësore për mbledhjen, përpunimin, vlerësimin dhe analizimin e të dhënave. Kjo metodologji ka përfshirë mbledhjen e të dhënave, statistikave dhe informacioneve nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare; vlerësimin e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe përshtatjen e tyre në kontekstin shqiptar; krijimin e një baze të qëndrueshme për rekomandimet dhe masat e propozuara.

Ky dokument ka si qëllim të analizojë në mënyrë të thelluar situatën aktuale të mirëqeverisjes; parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit; sundimin e ligjit për të evidentuar arritjet në kuadrin ligjor dhe institucional, por, nga ana tjetër, dobësitë e problematikat, si dhe drejtimet ku është e nevojshme të ndërhyhet, duke bërë një skanim të situatës aktuale. Kjo është realizuar nëpërmjet analizimit në mënyrë shteruese të dokumenteve dhe raporteve ndërkombëtare, të legjislacionit aktual shqiptar, të dokumenteve dhe politikave strategjike në këtë fushë më të hershme, por edhe ato që janë miratuar gjatë kohës së punës së ekspertëve, arritjet dhe gjetjet për sa u përket problematikave, duke u referuar te raportet ndërkombëtare apo ato të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë vendas.

Hartimi i Dokumentit Analitik, ishte një proces shumë voluminoz, por edhe më i zgjatur në kohë, pasi skanoi jo vetëm situatën për secilën nënfushë të shtyllave kryesore, por edhe ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë, gjithashtu, evidentuan standardet ndërkombëtare dhe praktikave më të mira të vendeve europiane për çështje të ndryshme, me qëllim që të rekomandoheshin rastet më të mira për t'u dhënë zgjidhje çështjeve të caktuara.

Procesi i hartimit të Dokumentit Analitik kaloi në disa faza dhe në një sërë procesesh për secilin shtyllë. Konkretisht po ju japim një informacion të plotë si vijon:

1.Ngritja e nëngrupeve të punës sipas tri shtyllave: “Mirëqeverisja”, “Antikorrupsioni” dhe “Sundimi i ligjit”

Mbështetur në vendimin nr. 50/2024, me qëllim garantimin e përfshirjes së të gjithë aktorëve të tjerë jopolitikë, por edhe garantimin e pavarësisë dhe profesionalizmit të dokumenteve që u hartuan, pranë KPP-së u ngrit dhe funksionoi Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), i asistuar nga Sekretariati Teknik (ST), i përbërë nga stafi i Kuvendit dhe i institucioneve publike. GENL-ja është organizuar në 3 nëngrupe, sipas fushave të objektit të veprimtarisë së komisionit të posaçëm: i) nëngrupi për mirëqeverisjen; ii) nëngrupi për antikorrupsionin; iii) nëngrupi për sundimin e ligjit.

Ky grup ekspertësh u ngrit pas një procesi tërësisht transparent dhe publik, me qëllim përfitimin e ekspertëve më të mirë, si përfaqësues të aktorëve të ndryshëm të rëndësishëm në këtë proces.

GENL-ja në total përbëhet nga 119 ekspertë të nivelit të lartë, nga të cilët janë 69 ekspertë të nivelit të lartë vendas dhe 50 ekspertë ndërkombëtarë. Nga ekspertiza vendase janë 12 ekspertë të propozuar nga institucionet dhe agjencitë e pavarura, 22 ekspertë nga bota akademike, 23 ekspertë të propozuar nga 21 organizata të shoqërisë civile dhe 12 ekspertë nga komuniteti i biznesit. Pjesë e GENL-së kanë qenë edhe 19 konsulentë të jashtëm nga diaspora, 14 konsulentë të huaj, si dhe 17 ekspertë të organizatave ndërkombëtare. Ekspertët shqiptarë nga diaspora, të cilët vijnë me eksperiencë nga fusha të ndryshme, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në universitetet më të mira europiane, profesionistë të fushës së ligjit dhe në organizata të ndryshme të ekspertizës për çështjet europiane, si: Itali, Holandë, Gjermani, Francë, Austri, Angli, SHBA, Kanada, e të tjerë, magjistratë të vendeve europiane, që shërbejnë në vende të

ndryshme si profesorë në universitete e të tjerë. Ndërsa 14 konsulentët e huaj janë kryesisht pedagogë të huaj, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në disa universitete të njohura europiane, magjistratë të vendeve europiane, ekspertë që kanë punuar me agjenci të ndryshme ndërkombëtare, që e njohin realitetin shqiptar, pasi kanë shërbyer edhe më parë me ekspertizë në këto fusha.

Me kërkesë të KPP-së, me qëllimin për të asistuar dhe monitoruar zbatimin e standardeve më të mira europiane në këtë proces, janë ftuar të kontribuojnë ekspertë nga organizata dhe institucione ndërkombëtare, që aktualisht operojnë në Shqipëri ose janë me seli në vende të tjera, ku si rezultat u atashuan si konsulentë të jashtëm pranë GENL-së 17 ekspertë ndërkombëtarë. Ekspertiza ndërkombëtare u ofrua nga delegacioni i BE-së në Shqipëri, Këshilli i Europës, GRECO-ja, OGP-ja, OSBE-ja, Banka Botërore, NDI-ja, USAID-i, ambasada e SHBA-ve, ambasada franceze, ambasada zvicerane e të tjerë, përmes projekteve të tyre të akredituara në Tiranë. Të gjithë ekspertët e tyre kanë dhënë kontribute me shkrim rreth draftit të Dokumentit Analitik dhe draftit të PKV-së, të cilat janë reflektuar nga GENL-ja në dokumentet përkatëse. Një pjesë e tyre kanë qenë, gjithashtu, pjesë e debateve *online* ose pjesëmarrës aktivë në tryezat e konsultimit publik.

Gjithashtu, veprimtaria e GENL-së është mbështetur nga 17 ekspertë të ST-së, si dhe rreth 20 institucione të administratës publike, ku këto të fundit kanë furnizuar me materiale dhe dokumente, të cilat kanë shërbyer në analizimin e situatës aktuale ligjore e institucionale.

2. Metodologjia e punës për hartimin e Dokumentit Analitik

Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë kanë punuar për një periudhë 7-mujore për të konceptuar dhe hartuar Dokumentin Analitik, të ndarë sipas tri shtyllave kryesore. Metodologjia e punës ka qenë e përcaktuar qartësisht edhe nga KPP-ja me qëllim që të krijoheshin premiset e përfitimit të një materiali sa më të plotë dhe shterues. Puna e GENL-së ka filluar në muajin gusht të vitit 2024 dhe ka vijuar deri në muajin shkurt të vitit 2025, me miratimin final të Dokumentit Analitik për të tria fushat.

Në vijim pranë GENL-së me ekspertë kombëtarë, është përfshirë edhe ekspertiza e huaj dhe ajo ndërkombëtare, e cila ka shërbyer si konsulte e jashtme për të përmirësuar Dokumentin dhe për të sjellë risitë e standardeve ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të vendeve europiane.

Nëngrupet e GENL-së për të tria shtyllat janë drejtuar nga një ekspert i nivelit të lartë për të koordinuar ekspertizën dhe ndjekjen e cilësisë, por edhe të afateve, si dhe janë koordinuar në aspektin teknik nga staf i Kuvendit, atashuar si Sekretariat Teknik, për të lehtësuar jo vetëm punën, por edhe mbledhjet dhe aktivitetet e tjera në kuadër të konsultimit publik.

Gjatë dy muajve të parë të fillimit të këtij procesi GENL-ja dhe ekspertët e ST-së u angazhuan për njohjen, skanimin dhe analizën e dokumentacionit të vënë në dispozicion, duke identifikuar vlerësimet, gjetjet, problematikat dhe rekomandimet përkatëse për të tria fushat që janë objekt i punës së KPP-së. Ekspertët e Nivelit të Lartë, të organizuar sipas 3 nëngrupeve, janë njohur dhe konsultuar mbi 15000 faqe dokumente, që kanë shërbyer si referenca bazë për hartimin e Dokumentit Analitik, të vëna në dispozicion nga Sekretariati Teknik pranë KPP-së. Referencat bazë përfshijnë, para së gjithash, gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet e raporteve të Komisionit European, udhërrëfyesit dhe strategjitë ndërsektoriale të miratuara nga Këshilli i Ministrave, raporte, gjetje dhe vlerësime të publikuara nga organizatat e shoqërisë civile, që veprojnë në vendin tonë, organizata të ndryshme ndërkombëtare, si dhe burime të ndryshme zyrtare nga institucionet e administratës publike.

Pjesë e metodologjisë së punës ka qenë jo vetëm ekspertiza individuale nga ekspertët e GENL-së, por edhe diskutimet në grupe pune të vogla, si dhe diskutimet dhe konsultimet me përfaqësues të institucioneve të ndryshme publike për të shkëmbyer mendime rreth problematikave dhe gjetjeve të tyre.

Diskutimi për strukturën e çështjeve që përmbante çdo shtyllë është kryer me GENL-në përpara miratimit të saj në mbledhjen e KPP-së, me qëllimin për të dëgjuar mendimet dhe sugjerimet e ekspertëve dhe prezantimin e qasjes së tyre në trajtimin e analizës të çështjeve që meritonin të trajtoheshin.

Gjatë muajit tetor të vitit 2024 GENL-ja dhe ST-ja kanë finalizuar punën për hartimin e një drafti të parë të Dokumentit Analitik, i cili bën vlerësimin dhe analizën e situatës aktuale në fushën e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit. Në këtë drejtim GENL-ja ka zhvilluar një sërë takimesh për të hartuar dhe diskutuar rreth hartimit të Dokumentit Analitik.

Me qëllim konsultimin publik dhe tërheqjen e mendimeve dhe komenteve, por edhe të informuar të interesuarit me ecurinë e punës për secilën shtyllë në muajin tetor u publikuan përmbledhjet ekzekutive të draftit të Dokumentit Analitik në uebsajtin e dedikuar www.masl.al.

Pas një pune voluminoze dhe konsultimit me të gjithë aktorët institucionalë dhe ekspertizën ndërkombëtare më 17 janar të 2025-ës GENL-ja ka prezantuar gjetjet kryesore dhe rekomandimet e Dokumentit Analitik për shtyllat: “Mirëqeverisja”, “Antikorrupsioni” dhe “Sundimi i ligjit”. Ky dokument u publikua, gjithashtu, edhe në uebsajtin e dedikuar të KPP-së.

Në prezantimin e Dokumentit Analitik për shtyllën e parë “Mirëqeverisja”, ekspertët e nëngrupit të GENL-së bënë një përmbledhje të gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore sipas 5 kapitujve që përbëjnë shtyllën e mirëqeverisjes: 1) transparencë në administratën publike; 2) integriteti dhe etika në administratën publike; 3) llogaridhënia e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor; 4) ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara; 5) efektiviteti dhe transparencë në menaxhimin e financave publike.

Në prezantimin e Dokumentit Analitik për shtyllën e dytë, “Antikorrupsioni”, ekspertët e GENL-së prezantuan gjetjet, problematikat dhe rekomandimet përkatëse për kapitujt “Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit politik”, “Parandalimi i korrupsionit në administratën publike, sektorët me risk më të lartë ndaj korrupsionit dhe sektorin privat”, “Funksionimi dhe eficientia e institucioneve që luftojnë korrupsionin, konfliktin e interesit dhe abuzimin me financat publike”, “Parandalimi i financimeve të paligjshme dhe pastrimit të parave” dhe “Ndërtimi i një shoqërie me integritet”.

Në prezantimin e Dokumentit Analitik të shtyllës së tretë “Sundimi i Ligjit”, ekspertët e GENL-së prezantuan një përmbledhje të gjetjeve dhe rekomandimeve për funksionin ligjvënës, mbikëqyrës, koordinues dhe monitorues të Kuvendit, efektivitetin e veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë, transparencën dhe llogaridhënien e tij, si dhe për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave themelore të njeriut.

KPP-ja, pas prezantimit të Dokumentit Analitik, caktoi deputetët relatorë për secilën shtyllë, përkatësisht zonjën Milva Ekonomi për shtyllën I; zonjën Etilda Gjonaj për shtyllën II dhe zotin Toni Gogu për shtyllën III, me qëllim përgatitjen e relacionit përkatës për debatin në komision dhe miratimin e dokumenteve përkatëse për të tria shtyllat.

3.Procesi i diskutimit dhe konsultimit publik të Dokumentit Analitik

Në kuadër të parimeve të transparencës dhe konsultimit publik, por edhe për të përfituar një analizë sa më të plotë, Dokumenti Analitik për të tria shtyllat i është nënshtruar procesit të konsultimit publik përmes diskutimeve, marrjes së mendimeve, takimeve në grup, prezantimeve në tryeza dhe forume publike, konferenca si dhe informimin e vazhdueshëm të qytetarëve. Për këtë qëllim KPP-ja ka ndërmarrë disa masa:

Në fillim të fazës së parë u krijua platforma e komunikimit publik dedikuar punës së KPP-së (www.masl.al), me qëllim mundësimin e plotë të punës për të dokumentuar të gjithë veprimtarinë, vendimet dhe dokumentet që do të prodhohen përgjatë mandatit të tij. Faqja ueb e komisionit mundësoi përfshirjen e çdo kontributi të mundshëm qytetar në përmirësimin e analizës, identifikimin e masave, që shërbejnë për ta thelluar këtë proces reformimi dhe përgjithësisht në procesin ligjvënës. Në hapësirën “Konsultim me publikun” janë krijuar rubrika të veçanta për të pyetur ekspertët apo anëtarët e komisionit, për të zhvilluar anketime të ndryshme, veçanërisht për konsultimin e çështjeve dhe nismave ligjore që do të dalin gjatë procesit të reformës.

Për të pasur një konsultim publik sa më të gjerë të Dokumentit Analitik KPP-ja së bashku me GENL-në kanë përgatitur dhe diskutuar një agjendë konsultimi publik të draftit të parë të analizës, me qëllimin përfitimin e komenteve dhe sugjerimeve nga të gjitha institucionet, grupet e interesit, organizatat e shoqërisë civile, profesorët dhe studentët, qytetarët etj. KPP-ja, nëpërmjet vendimit të mbledhjes, ka vendosur strategjinë dhe planin e punës së konsultimit publik për Dokumentin Analitik.

Pas vlerësimit dhe analizës paraprake të situatës aktuale në fushat e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit, GENL-ja dhe ST-ja nisën fazën e konsultimit publik të draftit të parë të Dokumentit Analitik. Në mënyrë të përmblendhur, për të garantuar transparencën dhe konsultimin publik jo vetëm të veprimtarisë, por edhe të gjetjeve kryesore të Dokumentit analitik, u realizuan:

- **U organizuan 11 tryeza publike gjatë periudhës nëntor-dhjetor të vitit 2024** në Kryesinë e Kuvendit, në të cilat ekspertët prezantuan aspekte të ndryshme të Dokumentit Analitik, ku morën pjesë aktorë të ndryshëm nga shoqëria civile, nga institucionet e pavarura, nga komuniteti i biznesit, nga institucionet shtetërore, studentë dhe grupe të tjera interesi, agjenci ligjzbatuese, universitete publike dhe jopublike, medie, dhomat e tregtisë, institucione financiare, anëtarë të KPP-së, përfaqësues të huaj të atashuar pranë komisionit nga delegacioni i BE-së, ambasada e SHBA-ve në Tiranë, prezenca e OSBE-së, OPDAT-i, UNDP-ja, Zyra e Këshillit të Europës, ambasada franceze, ambasada britanike, ambasada zvicerane etj.

Të gjitha sugjerimet dhe komentet janë analizuar dhe shqyrtuar nga GENL-ja, duke pasuruar dhe përmirësuar Dokumentin Analitik final, si dhe masat në Planin Kombëtar të Veprimit. Si rrjedhojë e procesit të konsultimit publik të Dokumentit Analitik janë identifikuar 191 komente/sugjerime të adresuara në Dokumentin Analitik për secilën shtyllë.

- Më 4 nëntor të vitit 2024 u organizua tryeza me temë “Integriteti i administratës publike dhe ofrimi i shërbimeve”, në kuadër të shtyllës “Mirëqeverisja” dhe shtyllës “Antikorrupsioni”.
- Më 5 nëntor të vitit 2024 u organizua tryeza me temë “Parandalimi i korrupsionit në sektorin privat dhe ndërtimi i një shoqërie me integritet”, në kuadër të shtyllës “Antikorrupsioni”.
- Më 11 nëntor të vitit 2024 u organizua tryeza me temë “Forcimi i kuadrit ligjor e institucional për parandalimin dhe luftën kundër abuzimit me financat publike dhe

transparenca në menaxhimin e tyre”, në kuadër të shtyllës “Mirëqeverisja” dhe shtyllës “Antikorrupsioni”.

- Më 12 nëntor të vitit 2024 u organizua tryeza me temë “Parandalimi i korrupsionit politik – Integriteti i të zgjedhurve dhe drejtuesve të nivelit të lartë dhe parandalimi i hapësirave të legjislacionit për korrupsion/lobim”, në kuadër të shtyllës “Antikorrupsioni”.
- Më 12 nëntor të vitit 2024 u organizua tryeza me temë “Procesi i rregullt ligjor dhe edukimi ligjor i publikut”, në kuadër të shtyllës “Sundimi i ligjit”.
- Më 13 nëntor të vitit 2024 u organizua tryeza me temë “Funksioni ligjvënës dhe forcimi i rolit të Kuvendit për zbatimin e ligjeve, si dhe efektiviteti, transparenca dhe llogaridhënia e vetë Kuvendit”, në kuadër të shtyllës “Sundimi i ligjit”.
- Më 15 nëntor të vitit 2024 u organizua tryeza me temë “Forcimi i rolit mbikëqyrës, koordinues dhe monitorues të Kuvendit, duke respektuar parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe përmirësimi i funksionit zgjedhës të Kuvendit, duke respektuar parimin e meritokracisë, transparencës dhe paanshmërisë”, në kuadër të shtyllës “Sundimi i ligjit”.
- Më 15 nëntor të vitit 2024 u organizua tryeza me temë “Parandalimi i pastrimit të parave dhe korrupsionit transnacional”, në kuadër të shtyllës “Antikorrupsioni”.
- Më 27 nëntor të vitit 2024 u organizua tryeza me temë “Garantimi i së drejtës së pronës dhe lufta kundër korrupsionit në sektorin e pronave”, në kuadër të shtyllës “Sundimi i ligjit” dhe shtyllës “Antikorrupsioni”.
- Më 6 dhjetor të vitit 2024 u organizua tryeza me temë “Qeverisja e hapur”, në kuadër të shtyllës “Mirëqeverisja”.
- Më 10 dhjetor të vitit 2024 u organizua tryeza me temë “Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në sektorët me risk të lartë në qeverisjen qendrore dhe vendore”, në kuadër të shtyllës “Antikorrupsioni”.

Pas tryezave tematike të organizuara në Kryesinë e Kuvendit, procesi i konsultimit publik vijoi edhe me forumet e dialogut qytetar në rrethe, kryesisht në mjediset universitare (universitetet publike dhe private), ku morën pjesë pedagogë, studentë, përfaqësues të organizatave vendore të shoqërisë civile, të komunitetit të biznesit dhe të institucioneve të qeverisjes vendore, si dhe qytetarë të interesuar për këto çështje.

Sa më sipër, gjatë periudhës janar - shkurt 2025 u organizuan 8 forume të dialogut qytetar në 5 qytete të vendit (Elbasan, Vlorë, Tiranë, Shkodër dhe Berat) për të prezantuar Dokumentin Analitik dhe draftplanet kombëtare të veprimit për secilën shtyllë.

▪ Tryeza dhe takime të nivelit të lartë “Shqipëria 2030 në BE – Rruga e reformave”.

Kuvendi i Shqipërisë organizoi takimin e nivelit të lartë “Shqipëria 2030 në BE – Rruga e reformave”, ku morën pjesë Kryeministri i Shqipërisë, ambasadori i BE-së në Tiranë, e ngarkuara me punë e SHBA-ve, ministra, përfaqësues të trupit diplomatik dhe të partnerëve ndërkombëtarë, anëtarë të KPP-së për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit, deputetë, përfaqësues të institucioneve shtetërore, të agjencive ligjzbatuese dhe të shoqërisë civile, ekspertë të nivelit të lartë dhe anëtarë të Sekretariatit Teknik të atashuar pranë KPP-së etj.

Ky takim u zhvillua në mbyllje të fazës së parë të veprimtarisë së KPP-së, atë të procesit të hartimit të Dokumentit Analitik (analizës së bërë nga ekspertët e atashuar në të tria shtyllat e KPP-së), si dhe të zhvillimit me sukses të 11 tryezave tematike publike dhe 8 forumeve konsultuese, ku morën pjesë rreth 1500 pjesëmarrës nga të gjitha grupet e interesit dhe të shoqërisë civile.

- **U zhvilluan takime koordinuese të vazhdueshme** me institucionet e pavarura, Këshillin e Ministrave, ministritë dhe institucionet e tjera, sipas fushës së përgjegjësisë, për të vënë në dispozicion të GENL-së të dhënat dhe informacionet e përditësuara.
- **U zhvilluan takime me partnerët ndërkombëtarë dhe përfaqësitë diplomatike**

U zhvillua takim me ambasadorët e vendeve të BE-së në tetor të vitit 2024

Ambasadori i BE-së në Tiranë ftoi kryetarin e KPP-së dhe anëtarë të tij në një takim pune me trupën diplomatike të ambasadorëve të 27 vendeve anëtare të Bashkimit Europian në Tiranë. Takimi u zhvillua në mjediset e “Europe House”. Ambasadori i BE-së, si mikpritës dhe organizator i takimit, bëri një prezantim të komisionit dhe pritshmërive ndaj tij në kuadër të procesit të negociatave me BE-në, ku theksoi domosdoshmërinë për të ndërtuar një proces sa më gjithëpërfshirës dhe transparent. Kreu i delegacionit të BE-së në Tiranë vlerësoi rolin e këtij komisioni dhe theksoi nevojën për të forcuar përfshirjen dhe besimin e qytetarëve dhe grupeve të interesit në këtë proces transformues. Kryetari i komisionit, pasi bëri një prezantim të vizionit, qëllimeve dhe synimeve që Kuvendi kërkon të realizojë përmes Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit”, për qasjen dhe metodologjinë e punës së komisionit, më pas informoi ambasadorët e BE-së për ecurinë e deritanishme të këtij procesi. Diskutimet në takim u fokusuan kryesisht te roli i KPP-së, te pritshmëritë e reformës dhe angazhimi i ekspertëve vendas e të huaj.

Ambasadorët shprehën mbështetjen për këtë nismë të Kuvendit të Shqipërisë, vlerësuan punën e deritanishme të komisionit dhe theksuan domosdoshmërinë për një bashkëpunim ndërinstitucional, rëndësinë e një reforme gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, që do të avancojë vendin tonë në rrugën drejt integritit në BE. Ambasadorët e vendeve të BE-së (Francës, Gjermanisë, Italisë, Suedisë dhe Çekisë) vlerësuan rëndësinë e këtij projekti ambicioz, të iniciuar dhe realizuar nga vetë autoritetet shqiptare dhe theksuan rëndësinë e përmbushjes së afateve dhe sigurimin e një procesi gjithëpërfshirës. Ambasadori i Spanjës mbështeti rëndësinë e kësaj reforme për vendin dhe solli për të pranishmit në takim përvojën e vendit të tij në këtë drejtim, ndërsa ambasadori i Holandës theksoi rëndësinë e llogaridhënies institucionale dhe të përfshirjes së opozitës në këtë proces.

Takime të anëtarëve të KPP-së me Bankën Botërore, si dhe me ekspertë ndërkombëtarë. Përfaqësuesit e Bankës Botërore vlerësuan rëndësinë e shumanshme të kësaj reforme për zhvillimin ekonomik e social të vendit dhe e konsideruan atë një reformë ambicioze dhe të nevojshme për procesin e integritit të Shqipërisë në BE. Njëherësh ata konfirmuan mbështetjen e tyre me asistencë teknike për këtë reformë dhe angazhimin e 6 ekspertëve të tyre në këtë proces, nga dy për secilën shtyllë.

Ekspertët që punuan për shtyllën “Antikorrupsioni” zhvilluan, gjithashtu, një takim me ekspertët ndërkombëtarë të caktuar nga Ambasada e SHBA-ve në Tiranë dhe delegacioni i Bashkimi Europian, pjesë e projekteve të asistencës, me qëllim prezantimin e gjetjeve paraprake të analizës lidhur me korrupsionin politik, sektorët me risk më të lartë ndaj korrupsionit, forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe abuzimeve, menaxhimin e financave publike, parandalimin e pastrimit të parave dhe ndërtimin e një shoqërie me integritet.

Anëtarët e KPP-së së bashku me disa nga ekspertët e GENL-së më 25 dhe 26 shkurt të vitit 2025 zhvilluan takime me drejtuesit e përgjithshëm të DG ENEST dhe DG JUST në Bruksel. Anëtarët e KPP-së dhe disa ekspertë të nivelit të lartë dhe të Sekretariatit Teknik të shtyllës “Antikorrupsioni” zhvilluan dy takime pune me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerimin dhe Fqinjësinë Lindore (DG ENEST) dhe të Drejtorisë së Përgjithshme për

Drejtesinë dhe Konsumatorët (DG JUST) në Komisionin Europian (Bruksel). Gjatë takimeve u bë prezantimi i punës dhe i përmbytjes së dokumenteve në fushat e mirëqeverisjes, antikorrupsionit dhe sundimit të ligjit, i metodologjisë së ndjekur për hartimin e Dokumentit Analitik dhe të Planit Kombëtar të Veprimit, gjithëpërfshirjen e ekspertëve shqiptarë të diasporës dhe ata ndërkombëtarë për zhvillimin e një procesi të gjerë konsultimi publik me shoqërinë civile dhe grupet e interesit. Përfaqësuesit e Komisionit Europian vlerësuan progresin e Shqipërisë dhe angazhimin për të çuar përpara luftën kundër korrupsionit në këtë fazë të rëndësishme të procesit të anëtarësimit në BE, si dhe iniciativat për të thelluar më tej reformat ekzistuese për përmbytjen e kriterëve të Grup-kapitullit I “Themeloret”. Ata mirëpritën vijimin e diskutimeve dhe bashkëpunimin e mëtejshëm për të përmirësuar rezultatet e punës së KPP-së.

Anëtarët e KPP-së dhe ekspertët zhvilluan një takim me përfaqësuesit e OGP-së. Në kuadër të punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit”, anëtarë të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, ekspertë të GENL-së dhe Sekretariati Teknik të shtyllës I – Mirëqeverisja, zhvilluan një vizitë pune në zyrat e *Open Government Partnership* (OGP) në Bruksel. Në takimin me përfaqësuesit e OGP-së u diskutua rreth gjetjes së mekanizmave të bashkëpunimit në fushën e qeverisjes së hapur dhe transparencës parlamentare, ku u propozuan disa hapa konkretë për të forcuar kornizën e mirëqeverisjes dhe për të integruar parimet e OGP-së për transparencën, llogaridhënien, integritetin dhe gjithëpërfshirjen në punën e KPP-së dhe të Kuvendit.

Në këtë takim u ra dakord që *Open Government Partnership* të ofrojë rekomandime për shtyllën “Mirëqeverisja” si dhe për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit. Gjithashtu, u ra dakord që në Dokumentin Analitik të shtohet një kapitull për “Qeverisjen e hapur”, duke e pozicionuar atë si një komponent kyç që lidh dhe koordinon veprimet e tri shtyllave të analizës. Për të mbështetur stafin parlamentar në zbatimin e këtyre reformave, OGP-ja do të ofrojë një paketë udhëzimesh dhe mjeteve praktike të *Open Parliament* për rritjen e transparencës dhe angazhimit qytetar në proceset parlamentare.

▪ Konferenca për mediat

Kryetari i Komisionit të Posaçëm, ka organizuar bashkëbisedime me përfaqësues të medias për t’i njohur ata me punën e bërë nga Komisioni i Posaçëm dhe Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, me hapat e ndërmarra, duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre lidhur me çështje të caktuara që janë objekt i punës së KPP-së.

▪ Botime dhe publikime të tjera

KPP-ja gjatë gjithë procesit dhe fazave të ndjekura që në krijimin e tij, për të informuar në kohë reale e në mënyrë transparente publikun dhe aktorët e interesuar, si dhe për t’i bërë pjesë të procesit, ka ndërmarrë, përveç sa më sipër, edhe disa masa:

- Botimi dhe publikimi i 12 buletineve periodike mujore informative (shqip – anglisht) në uebsajtin e dedikuar, si dhe shpërndarjen me *email* tek të gjithë aktorët lidhur me veprimtarinë mujore dhe ecurinë e proceseve.
- KPP-ja ka zhvilluar 12 mbledhje publike, të transmetuara *live* në uebsajtin e Kuvendit dhe të komisionit, si dhe në rrjetet sociale të Kuvendit.

- Botimi në uebsajtin e dedikuar të 29 vendimeve të KPP-së gjatë veprimtarisë së tij.
- Zhvillimi i disa takimeve periodike informuese me gazetarët dhe përfaqësuesit e medias, për t'i informuar mbi aktivitetin e KPP-së dhe procesin e ndjekur nga GENL-ja.
- Takime periodike me shoqërinë civile, që monitoron procesin dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë për t'i informuar në të gjitha fazat e procesit.
- Transmetimi *live* i të gjitha takimeve të komisionit, si dhe i tryezave tematike për t'u ndjekur live nga media dhe çdo i interesuar, të cilat gjenden gjithashtu në uebsajtin e dedikuar të komisionit dhe atë të Kuvendit.
- **Prezantimi dhe miratimi në parim i Dokumentit Analitik**

Në mbledhjen e KPP-së, datë 17.1.2025, përfaqësuesit e GENL-së dhe ST-së prezantuan draftin e Dokumentit Analitik, që përfshin të tria shtyllat: “Mirëqeverisjen”, “Antikorrupsionin” dhe “Sundimin e ligjit”. KPP-ja, pasi dëgjoi prezantimet, vendosi të nisë shqyrtimin në komision të Draftdokumentit Analitik, si dhe caktoi relatorët që do të shqyrtojnë e relatojnë projektin për secilën nga shtyllat.

Në mbledhjet e datës 19.02.2025 dhe 26.02.2025 KPP-ja, pasi dëgjoi relatorët për shtyllat: “Mirëqeverisja”, “Antikorrupsioni” dhe “Sundimi i ligjit” si dhe pas diskutimeve vendosi të miratojë Dokumentin Analitik për secilën shtyllë. Si rezultat, KPP-ja ka miratuar Dokumentin Analitik konkretisht me:

- Vendimin nr. 22, datë 19.02.2025 “Për miratimin e Dokumentit Analitik për shtyllën e parë “Mirëqeverisja”.
- Vendimin nr. 24, datë 19.02.2025 “Për miratimin e Dokumentit Analitik për shtyllën e dytë “Antikorrupsioni”.
- Vendimin nr. 25, datë 26.02.2025 “Për miratimin e Dokumentit Analitik për shtyllën e tretë “Sundimi i Ligjit”.

Relatorët në mbledhjen publike të KPP-së bënë një përmbledhje të metodologjisë së punës, të fazave nëpër të cilat ka kaluar analiza, të procesit të konsultimeve dhe diskutimit të tij në tryezat publike të organizuara gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2024 dhe forumet publike në rrethet: Shkodër, Durrës, Elbasan, Vlorë dhe Berat. Gjatë prezantimit relatorët u ndalën te gjetjet kryesore të analizës, si dhe morën komentet e institucioneve të pavarura dhe ekzekutivi, organizatat ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile, bota akademike dhe biznesi etj. Po ashtu prezantuan edhe rekomandimet kryesore që GENL-ja ka adresuar, si dhe drejtimit e mundshme për ndërhyrje, të cilat kanë shërbyer si bazë për ndërtimin e planit të veprimit për të tria shtyllat kryesore. Relatorja e shtyllës “Antikorrupsioni” prezantoi strukturën e rishikuar dhe *feedback*-un e 5 ekspertëve të atashuar nga programet e NDI-së me mbështetje të USAID-it.

Në mbledhjen e komisionit ishin ftuar për t'iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve ekspertët e GENL-së. Pas diskutimit të anëtarëve të KPP-së në mbledhjet e komisionit u miratuan të tria dokumentet analitike.

V. Përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektaktit

Dokumenti Analitik përmban një analizë prej rreth 709 faqesh dhe 494 rekomandime të evidentuara nga ekspertët e atashuar pranë KPP-së. Dokumenti Analitik për secilën shtyllë është i organizuar sipas strukturës së miratuar me vendimin nr. 13, datë 19.7.2024 të KPP-së. Një aspekt i rëndësishëm i Dokumentit Analitik është trajtimi i çështjeve të caktuara sipas fushave tematike/kapitujve, duke garantuar një analizë holistike të situatës aktuale, progresit dhe arritjeve në fushat respektive, gjetjeve dhe problematikave të pasqyruara, veçanërisht në

raportet e BE-së, si dhe drejtimeve për ndërhyrje/rekomandimeve të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) për adresimin e gjetjeve dhe problematikave.

Struktura e analizës është e organizuar në mënyrë të tillë, që për çdo çështje të ofrohet një pasqyrë e situatës aktuale, duke shqyrtuar masat ligjore dhe institucionale të zbatuara. Më pas për secilën çështje janë identifikuar problematikat dhe mangësitë, të cilat janë konstatuar nga një gamë e gjerë burimesh, duke përfshirë raportet e BE-së mbi progresin e Shqipërisë në procesin e integritetit, raportet *screening* për Grup-kapitullin I “Themeloret” dhe ato “Për shtetin e së drejtës”, si dhe pozicionin e përbashkët negociues të Shqipërisë me BE-në për Grup-kapitullin I “Themeloret”. Gjithashtu, janë përfshirë raportet e mekanizmave ndërkombëtarë, si: Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL), *Transparency International*, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Partneriteti për Qeverisje të Hapur (OGP) etj. Referencë është bërë gjithashtu dhe te raportet e organizatave të shoqërisë civile, që ofrojnë perspektivën lokale dhe të detajuar mbi situatën, si dhe te gjetjet e ekspertëve, të cilët kanë evidentuar mangësi dhe hapësira në kuadrin ligjor dhe institucional.

Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë pranë KPP-së, që u angazhuan për hartimin e këtij dokumenti, i kompozuar me profile të ndryshme profesionale, ka synuar të sjellë një produkt cilësor dhe një analizë sa më të plotë të tematikës, por vlen të theksohet se natyra dinamike dhe multidisiplinare e çështjeve që u përkasin të tria shtyllave, mund të mos ketë lejuar shterimin total të të gjitha aspekteve që shoqërojnë këto fusha.

▪ Shtylla I “Mirëqeverisja”

Dokumenti Analitik për shtyllën I “Mirëqeverisja” organizohet në 6 fusha tematike/kapituj: (i) “Transparenca në administratën publike”; (ii) “Integriteti dhe etika në administratën publike”; (iii) “Llogaridhënia e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor”; (iv) “Ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara”; (v) “Efektiviteti dhe transparenca në menaxhimin e financave publike”; (vi) “Qeverisja e hapur, efienca dhe performanca në administratën publike”.

Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të evidentuara në raportet e Komisionit European në lidhje me mirëqeverisjen në Shqipëri, të ndara sipas kapitujve të analizës:

Për sa i përket kapitullit “Transparenca në administratën publike”, Shqipëria ka sfida për përmirësimin e legjislacionit, krijimin e hapësirave më të mëdha për konsultimin publik dhe garantimin e aksesit për të gjitha grupet e shoqërisë, monitorimin më efikas mbi zbatimin e ligjit për konsultimin publik, rritjen e kapaciteteve të nëpunësve, në veçanti në pushtetin vendor, për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi etj. Për të adresuar këto sfida dhe për të rritur besimin e qytetarëve tek administrata publike BE-ja ka dhënë rekomandime të ndryshme.

Siç vihet në pah edhe në raportin më të fundit të progresit të Komisionit European (2024), autoritetet publike duhet të forcojnë transparencën me përgjegjësi më të lartë. Në këtë fushë Shqipëria ka ende sfida, ku duhet të zbatojë me efikasitet legjislacionin lidhur me të drejtën e informimit, si dhe për të forcuar rolin e koordinatorëve për informimin.

Në lidhje me konsultimin publik, BE-ja vlerëson se përqindja e akteve që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik duhet të rriten bazuar në një interpretim më gjithëpërfshirës të kriterëve të ligjit “Për konsultimin publik” dhe duhen më shumë nisma për të inkurajuar grupet e interesit, në veçanti shoqërinë civile, për të marrë pjesë në këto procese. Gjithashtu, BE-ja

nënvizon se cilësia e raporteve të vlerësimit të ndikimit (RIA) duhet të rritet edhe për të thjeshtuar proceset për qytetarët, edhe për të rritur aksesin e të gjitha grupeve në informacion.

Në lidhje me kapitullin e dytë “Integriteti dhe etika në administratën publike”, një nga objektivat e administratës publike është rritja e efektshmërisë në të gjitha nivelet përmes zbatimit të rolit, funksioneve dhe përgjegjësive me integritet individual dhe profesional. Në këtë kuptim, objektivat shumëdimensionalë të administratës publike kërkojnë që efektshmëria të mos jetë e përqendruar vetëm tek analiza kosto-përfitim, por ajo duhet të përfshijë elementin thelbësor, që është vlerë e shtuar për qytetarët, përmes ofrimit të një shërbimi të vlefshëm e në kohë, duke pasur parasysh që qytetarët janë financuesit dhe përfituesit e drejtpërdrejtë. Përmes politikave qeveritare synohet që institucionet e administratës publike të ofrojnë garanci për respektimin e të drejtave të qytetarëve nëpërmjet zbatimit në praktikë të parimit të ligjshmërisë. Për këtë arsye, në mënyrë që të mbrohet interesi publik gjatë ushtrimit të veprimtarisë së këtyre institucioneve, kërkohet që ato të veprojnë me integritet dhe në mënyrë transparente.

Lidhur me rekomandimet e BE-së dhe sfidat që ka vendi, theksohet se duhet të përmirësohet ndërgjegjësimi i zyrtarëve publikë për standardet etike dhe mënyrën se si ato zbatohen për një administratë me integritet, po ashtu duhet të rritet cilësia dhe zbatimi i planeve të integritetit, të vendosura në nivel qendror dhe lokal. Krijimi i kulturës së integritetit mbetet një sfida, me qëllim që të garantohet që normat, strukturat dhe proceset administrative të garantojnë ushtrimin e veprimtarisë së zyrtarëve publikë në të mirë të interesit publik.

Për sa i përket kapitullit të tretë “Llogaridhënia e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor”, mund të argumentohet se llogaridhënia është parakushti themelor për të parandaluar abuzimin e pushtetit dhe për të siguruar që pushteti të orientohet drejt rritjes së efikasitetit, efektivitetit, përgjegjësisë dhe transparencës.

Për sa i përket llogaridhënies, BE-ja rekomandon miratimin sa më parë të strategjisë së re të reformës së administratës publike, si dhe rishikimin e efektivitetit të strukturave aktuale të monitorimit, për të garantuar qëndrueshmërinë e reformave. Gjithashtu, rekomandohet të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive dispozitat për rekrutimin, promovimin dhe shkarkimin e bazuar në merita, në përputhje me ligjin e shërbimit civil në të gjitha nivelet, veçanërisht në nivelin e lartë, dhe të fillojë sërish automatizimi i sistemit të listës së pagave. Në këtë drejtim Shqipëria ka sfida, për të garantuar një shërbim civil bazuar në meritë, profesionalizëm, paanësi dhe performancë të lartë në realizimin e interesit publik.

Ndryshimet në legjislacionin e shërbimit civil janë të nevojshme për të përmirësuar mekanizmat e vlerësimit të performancës, për promovimin dhe karrierën në shërbimin civil. Po ashtu duhet të përmirësohet legjislacioni në lidhje me kriteret për krijimin e organeve vartëse, si dhe linjat e llogaridhënies ndërmjet organeve mbikëqyrëse dhe atyre vartëse, që duhet të zbatohen në të gjithë administratën.

Kuvendi duhet të forcojë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit dhe të trajtojë problemin e mungesës së reagimit të organeve të administratës publike, me qëllim forcimin e mekanizmave të llogaridhënies.

Forcimi i kapaciteteve administrative për ta bërë menaxhimin më të përgjegjshëm/llogaridhënës i shërben po ashtu këtij qëllimi. Sistemi i qeverisjes/menaxhimit të ndërmarrjeve shtetërore (NSH) duhet të përmirësohet dhe sfida mbetet që qeverisja e NSH-ve të përputhet plotësisht me standardet ndërkombëtare, gjë që duhet të reflektohet edhe në qëndrueshmërinë financiare të këtyre ndërmarrjeve, në pronësinë shtetërore të tyre, si dhe te standardet e raportimit fiskal dhe jofiskal të tyre.

Lidhur me pushtetin vendor, dokumenti vë në pah nevojën për përmirësimin e burimeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore, kapacitetin administrativ dhe autonominë e tyre. Sfidë mbetet përmirësimi dhe forcimi i efikasitetit, transparencës, llogaridhënies dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor, në linjë me parimin e decentralizimit, autonomisë dhe subsidiaritetit në ofrimin e shërbimeve.

Për sa i përket kapitullit të katërt “Ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara”, vlen të përmendet se një nga elementet thelbësore në procesin e integritetit të Shqipërisë në BE është modernizimi i ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët dhe biznesin. Ky proces transformues nuk është vetëm një kërkesë nga BE-ja, por edhe një nevojë e brendshme për përmirësimin e cilësisë së qeverisjes. Procesi i digjitalizimit të shërbimeve publike ka kulmuar me krijimin e platformës qeveritare e-Albania.

Shqipëria përballlet me sfida për zbatimin e standardeve të sigurisë në administratën publike dhe mbrojtja e të dhënave personale të qytetarëve duhet të jetë prioritet, për të siguruar besimin e publikut në shërbimet digjitale, si dhe të jenë të harmonizuara me standardet dhe legjislacionin europian, për të përmbushur kriteret e anëtarësimit në BE. Në këtë fushë BE-ja rekomandon përmirësimin dhe konsolidimin e kuadrit ligjor për shërbimet digjitale, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave në përputhje me *acquis*-në e BE-së. Gjithashtu, BE-ja rekomandon akses të barabartë në shërbimet *online* për të gjithë qytetarët dhe në këtë drejtim mbetet sfida përmirësimi i cilësisë, infrastrukturës digjitale dhe aksesit i barabartë për të gjithë qytetarët si në zonat urbane, ashtu edhe rurale. Sfidë mbetet ofrimi i shërbimeve për grupet vulnerabël (personat me aftësi të kufizuara, mosha e tretë, persona që nuk kanë mundësi/janë të paaftë të përdorin shërbimet *online*, komuniteti rom/egjiptian, etj.) dhe përshtatja e platformave ekzistuese *online* për këto kategori personash, në mënyrë që të garantohet akses i njëjtë në shërbime pa diskriminim.

Në lidhje me kapitullin e pestë “Efektiviteti dhe transparenca në menaxhimin e financave publike”, zbatimi i reformës së menaxhimit të financave publike (MFP) shërben si udhërrëfyes për Shqipërinë, për të ruajtur qëndrueshmërinë e financave publike. Objektivi i përgjithshëm i strategjisë së reformës së MFP-së është të arrijë një buxhet më të balancuar dhe të qëndrueshëm, me një raport të reduktuar të borxhit përmes menaxhimit financiar më të fortë dhe proceseve të kontrollit dhe auditimit, ku ekzekutimi i buxhetit është i lidhur siç duhet me politikat e qeverisë.

Në këtë fushë Shqipëria duhet të përmbushë rekomandimet për rritje të qëndrueshmërisë së parashikueshmërisë së tavanëve buxhetore afatmesme, nëpërmjet përcaktimit të treguesit: devijime të tavanëve të programit buxhetor afatmesëm/nga tavanit buxhetor i miratuar nga Kuvendi. Gjithashtu, nga BE-ja kërkohet monitorim efektiv i risqeve fiskale, veçanërisht atyre që lidhen me detyrimet kontingjente të ndërmarrjeve shtetërore. Në këtë drejtim mbetet synim dhe sfida ngritja e një strukture të pavarur monitoruese për vlerësimin e risqeve fiskale dhe monitorimin e tyre në përputhje me rregullat fiskale. Rritja e transparencës dhe përmirësimi i mekanizmave në drejtim të kontratave me sektorin privat është një tjetër sfida për të përmbushur rekomandimin për hartimin dhe miratimin e metodologjisë së përditësuar për inventarizimin, vlerësimin dhe zhvlerësimin e aseteve në sektorin publik.

Për sa i përket kapitullit “Qeverisja e hapur, efienca dhe performanca e administratës publike”, siguri i aksesit në informacionin legjislativ dhe krijimi i mekanizmave për pjesëmarrjen e publikut janë thelbësore për ndërtimin e një marrëdhënieje transparente dhe besimi me qytetarët. Ky angazhim është vendimtar edhe për progresin e përgjithshëm të

Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE, edhe për krijimin e një roli më aktiv dhe më kuptimplotë të Kuvendit në zhvillimin e vendit.

Iniciativa globale e Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (OGP) shërben si një platformë për bashkëveprim dhe partneritet, për një vendimmarrje më të mirë dhe gjithëpërfshirëse, për kryerjen e reformave për të zhvilluar iniciativa që rrisin transparencën, fuqizojnë qytetarët, luftojnë korrupsionin dhe përdorin teknologjitë e reja për të përmirësuar qeverisjen. Shqipëria ka theksuar vendosmërinë e saj edhe në Planin Kombëtar të Veprimit 2023-2025 të Qeverisjes së Hapur për të promovuar, mbështetur dhe zhvilluar politika specifike për një qeverisje të hapur, në të cilën transparenca, digjitalizimi i administratës, lufta kundër korrupsionit, drejtësia, përfshirja institucionale dhe llogaridhënia të përfaqësojnë vlera vendimtare në zhvillimin e demokracisë, bazën e politikave në nivel të qeverisjes, duke respektuar agjendën e qytetarëve. Gjithashtu, Plani Kombëtar i Veprimit 2023-2025 për Qeverisjen e Hapur thekson përmirësimin e efikasitetit të administratës shtetërore dhe publike, me qëllim plotësimin e nevojave të qytetarëve dhe ekonomisë, si dhe masat që synojnë forcimin e transparencës, përgjegjësisë dhe integritetin.

▪ **Shtylla II “Antikorrupsioni”**

Dokumenti Analitik për shtyllën II “Antikorrupsioni” organizohet në 9 fusha tematike/kapituj: (i) “Kuatridhe institucional dhe rregullator për luftën kundër korrupsionit”; (ii) “Integriteti i zyrtarëve publikë”; (iii) “Financimi politik”; (iv) “Procesi legjislativ”; (v) “Kontrolli financiar dhe menaxhimi i financave publike”; (vi) “Rregullimi i tregut dhe konkurrueshmëria”; (vii) “Funksionet e qeverisjes dhe sektorët me risk të lartë korrupsionit”; (viii) “Parandalimi i financimeve të paligjshme dhe pastrimi i parave”; (ix) “Rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit shoqëror në luftën kundër korrupsionit”. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore, të evidentuara në raportet e Komisionit Europian në lidhje me luftën kundër korrupsionit në Shqipëri, të ndara sipas kapitujve të analizës, përfshijnë:

Në lidhje me kapitullin e parë “Kuatridhe institucional dhe rregullator për luftën kundër korrupsionit”, evidendohet fragmentim i ndjeshëm institucional, mbivendosje e kompetencave ndërmjet institucioneve dhe strukturave që trajtojnë korrupsionin, e cila shkakton konfuzion dhe mungesë koordinimi, duke dobësuar përgjigjen institucionale ndaj rasteve të raportuara. Në aspektin e kuadrit rregullator është konstatuar si problematikë mungesa e analizave, që paraprijnë hartimin e dokumenteve strategjike, mungesa e vlerësimit të efikasitetit të masave të zbatuara nga dokumentet pararendëse, si dhe mungesa e monitorimit të efektshëm dhe koordinimit institucional të akteve strategjike. Gjithashtu, analiza ka nxjerrë në pah se disa mekanizma të zbatuara deri tani, si: plani i integritetit, kanë pasur efikasitet të kufizuar, ndër të tjera, për shkak të mungesës së standardizimit të tyre, si dhe mungesës së mbikëqyrjes nga një institucion i pavarur, që do të siguronte uniformitetin në hartimin, kuptimin dhe zbatimin e këtyre instrumenteve.

Në lidhje me kapitullin e dytë “Integriteti i zyrtarëve publikë”, disa nga gjetjet kryesore, të konstatuara nga analiza, përfshijnë: mungesën e përafrimit të kuadrit rregullues për konfliktin e interesit me standardin në BE; mungesën e të dhënave apo historikut mbi zbatimin aktual të kuadrit për konfliktin e interesit në të gjitha nivelet e qeverisjes; mungesën e raportimeve dhe të dhënave të sakta e të ndara varësisht llojit të shkeljes nga ana e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) për ligjet brenda fushës së saj të kompetencës. Në raport me zyrtarët e lartë, analiza ka nxjerrë në pah mungesën e mekanizmave ndëshkues të qartë dhe strukturave mbikëqyrëse efikase për zbatimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit; mungesën një kuadri të plotë për kufizimet e paspunësimit dhe instrumenteve efikase të zbatimit të tyre për anëtarët e Këshillit të Ministrave, këshilltarët

politikë dhe nëpunësit publikë të të gjitha niveleve. Gjithashtu, për nëpunësit publikë është konstatuar, gjithashtu, ekzistenca e një rrejtje të decentralizuar e të paharmonizuar aktesh për konfliktin e interesit, si dhe mungesa e standardizimit të kodeve të etikës së institucioneve qendrore apo vendore.

Në lidhje me deklarin e pasurisë dhe interesave analiza ka nxjerrë në pah, ndër të tjera, se ILDKPKI-ja nuk ka mandat për të verifikuar pasuritë që mund të jenë fshehur përmes subjekteve private ose të individëve të tjerë, një mangësi që krijon hapësira për abuzime dhe përfitime të paligjshme, si dhe janë vënë re sfida të këtij institucioni lidhur me kapacitetet institucionale për verifikimin e deklarave të pasurisë. Në raport me lobimin, konstatimi kryesor është nevoja për të pasur një kuadër rregullues të plotë të veprimtarisë së lobistëve, përveç normave që përcaktojnë detyrime për zyrtarët e lartë. Në raport me sinjalizimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit, grupi i ekspertëve ka konstatuar se mekanizmat për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve janë joefektivë, me një numër të ulët raportimesh, ku autocensura dhe mungesa e garancive të mbrojtjes luajnë një rol frenues. Për të adresuar gjetjet e evidentuara, rekomandimet kryesore fokusohen në: forcimin e integritetit, përmes përmirësimit të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, i cili duhet të reflektojë standardet më të mira europiane, duke përfshirë detyrimin për të saktësuar rolin e institucioneve përgjegjëse për të monitoruar zbatimin e ligjit dhe publikimin e të dhënave të sakta mbi zbatueshmërinë e tij; forcimin e kuadrit rregullues për integritetin e zyrtarëve të lartë, përmes plotësimit dhe saktësimit të përmbajtjes së kodeve të etikës/sjelljes; përcaktimin e mekanizmave zbatues/mbikëqyrës të pavarur dhe efikasë, si dhe përcaktimi i procedurave dhe sanksioneve të qarta që zbatohen për secilën shkelje.

Në lidhje me deklarin e pasurisë, rekomandimet kryesore lidhen me zgjerimin e kompetencave të ILDKPKI-së për të kryer verifikimin e pasurive që mund të kalojnë përmes individëve të tjerë apo subjekteve private etj.

Për sa i përket kapitullit të tretë “Financimi i partive politike”, disa nga gjetjet kryesore përfshijnë: mungesën e përcaktimit në Kodin Zgjedhor të kategorive të personave juridikë që nuk lejohen të japin fonde për fushatat zgjedhore; mungesën e sanksioneve të qarta në dispozitat që përcaktojnë ndalimin e medias për ofrimin e fondeve ndaj partive politike; transparencën e kufizuar në raportet vjetore të partive politike, si dhe mungesën e raportimit të detajuar të fushatave dhe aktiviteteve digjitale. Në këtë drejtim rekomandimet kryesore lidhen me ndryshimet në Kodin Zgjedhor; miratimin e një ligji të posaçëm “Për financimin e partive politike”; publikimin e informacionit financiar nga partitë; auditimin financiar të partive politike; krijimin e platformave digjitale për raportim në kohë reale, që mund të lehtësojë aksesin dhe kontrollin publik.

Në lidhje me kapitullin e katërt “Procesi legjislativ”, analiza ka evidentuar se Kuvendi ka shfaqur progres në lidhje me transparencën e punës së tij, aksesin e publikut në informacion dhe pjesëmarrjen e tyre në veprimtarinë parlamentare. Megjithatë, vendi vijon të përballët me sfida të rëndësishme në procesin legjislativ, ku shpeshherë interesat individuale dhe grupet e forta të interesit ndikojnë në përmbajtjen e ligjeve. Kjo rrit rrezikun e korrupsionit, dëmton transparencën, cenon llogaridhënien dhe integritetin në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore. Në këtë drejtim, nënvizohet rëndësi e forcimit të mëtejshëm të mekanizmave për vlerësimin parandalues të korrupsionit në projektligje. Gjithashtu, rekomandohet forcimi i mekanizmave për publikimin dhe diskutimin publik të projektligjeve, duke garantuar një afat të përshtatshëm konsultimi me qytetarët, shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara.

Për sa i përket kapitullit të pestë “Kontrolli financiar dhe menaxhimi i financave publike”, analiza identifikon disa problematika kryesore, të evidentuara në raportet e Komisionit European, që ndikojnë në funksionimin e institucioneve.

Në fushën e kontrollit financiar dhe auditimit, konstatohet se sistemet e kontrollit të brendshëm në institucionet publike dhe shoqëritë tregtare me pjesëmarrje publike janë shpesh të paefektshme dhe të pamjaftueshme. Auditimi i brendshëm përballet me planifikim të dobët, moszbatim të plotë të rekomandimeve dhe mungesë të burimeve njerëzore të certifikuara. Po ashtu raportet e auditimit shpesh nuk përputhen me standardet ndërkombëtare, duke ndikuar negativisht në transparencën dhe llogaridhënien institucionale. Në drejtim të inspektimit financiar publik, nënvizohet, ndër të tjera, nevoja për harmonizimin e legjislacionit me direktivën e BE-së në luftën kundër mashtrimit ndaj interesave financiare të BE-së.

Lidhur me kontrollin e jashtëm, evidentohet se Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ndërmarrë hapa pozitivë në përmirësimin e kapaciteteve institucionale, megjithatë, ka ende nevojë për përmirësime në bashkëpunimin ndërinstitutional dhe të rrisë nivelin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm.

Për sa i përket kapitullit të gjashtë “Rregullimi i tregut dhe konkurrueshmëria”, analiza ka nxjerrë në pah se, pavarësisht përpjekjeve për të adresuar korrupsionin, përgjithësisht përmes masave me karakter ndëshkues, në sektorin privat në tërësi dhe tregjet me efekt të ndjeshëm në ekonomi, ende ka mangësi në lidhje me transparencën, forcimin e integritetit të këtij sektori në tërësi dhe mungesën e instrumenteve specifike për parandalimin e korrupsionit, ndërsa tregjet e rregulluara, që i nënshtrohen një kuadri rregullator dhe mbikëqyrës më të ndërlikuar e kompleks, që synon ruajtjen e integritetit të operatorëve, përballen me këto sfida, si: mungesën e transparencës së plotë lidhur me rregullat për menaxhimin e konfliktit të interesit, mungesën e publikimit të kodeve të drejtimit të brendshëm apo zbatimit të programeve të posaçme antikorrupsion.

Nga ana tjetër, për sa u përket institucioneve me kompetenca mbikëqyrëse, rregulluese dhe kontrolluese të tregut (Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare), konstatohet një mungesë e kërkesave të qarta e substanciale për shqyrtimin e integritetit për drejtuesit e lartë, si dhe mekanizmave institucionale për verifikimin e thelluar të profesionalizmit dhe integritetit. Gjithashtu, vihet re mungesa e instrumenteve të posaçme antikorrupsion, si dhe rregullimi i plotë dhe i qartë lidhur me kufizimet e paspunësimit (*revolving doors*) për anëtarët e organeve drejtuese të autoriteteve me kompetenca mbikëqyrëse apo rregullatorë të tregut. Pjesë e analizës kanë qenë edhe ndërmarrjet shtetërore, për të cilat është vënë në dukje nevoja për të përforcuar masat me natyrë parandaluese të korrupsionit.

Për sa i përket kapitullit të shtatë “Funksionet e qeverisjes dhe sektorët me risk të lartë korrupsioni”, janë identifikuar disa problematika kryesore:

Administrimi i të drejtave të pronësisë në Shqipëri mbetet një sfidë komplekse, që kërkon përpjekje të vazhdueshme për zgjidhjen e problematikave të trashëguara dhe përballjen me sfidat aktuale, ku ndër më kryesoret përmendim korrupsionin; ritmet e ngadalta të digjitalizimit dhe përmirësimit të të dhënave kadastrale; vonesat në proceset e legalizimit dhe regjistrimit fillestar; nevoja për bashkëpunim më efektiv mes institucioneve; forcimi i transparencës dhe integritetit institucional.

Në fushën e prokurimeve publike, koncesioneve dhe PPP-ve, pavarësisht masave të ndërmarra në nivel politik, ligjor dhe institucional, ka ende nevojë për përmirësime të mëtejshme në:

kuadrin ligjor, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, forcimin e kapaciteteve, si dhe rritjen e profesionalizmit të strukturave përgjegjëse. Po ashtu, rritja e konkurrencës dhe pjesëmarrjes në prokurime, si dhe fuqizimi i mekanizmave të kontrollit janë të domosdoshëm për të kufizuar abuzimet.

Investimet strategjike luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe tërheqjen e kapitalit vendas e të huaj, por problematikat e identifikuara nënvizojnë nevojën për përmirësime të mëtejshme në: kuadrin ligjor, forcimin e transparencës dhe llogaridhënies, krijimin e mekanizmave efektivë për monitorim dhe raportim periodik, shmangien e konfliktit të interesit dhe garantimin e integritetit në vendimmarrje.

Administrata tatimore, pavarësisht përparimeve të arritura përmes digjitalizimit, fiskalizimit dhe automatizimit të shërbimeve, vijon të përballlet me sfida të rëndësishme, këto përfshijnë: reduktimin e kompleksitetit dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së kuadrit ligjor dhe rregullator; rritjen e transparencës dhe eficiencës së kontroleve, përdorimin më efektiv të të dhënave, uljen e përdorimit të parasë *cash*, forcimin e mekanizmave për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe plotësimin e vakancave për të siguruar një administratë tatimore më të qëndrueshme dhe funksionale.

Ndërkohë, tek administrata doganore problematikat kryesore mbeten: lufta kundër kontrabandës dhe korrupsionit, harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit me *acquis*-në e BE-së, avancimi i digjitalizimit dhe forcimi i kapaciteteve institucionale, përmirësimi i menaxhimit të riskut dhe një bashkëpunim më efektiv ndër-institucional, me qëllim sigurimin e një administrate më efikase dhe transparente. Për të adresuar problematikat e identifikuara në raportet vendase dhe ndërkombëtare, rekomandohet forcimi i integritetit në Policinë e Shtetit, përmes zbatimit efektiv të planeve të integritetit dhe rritjes së transparencës për donacionet, sponsorizimet dhe shërbimet e ofruara kundrejt pagesës. Gjithashtu, rishikimi i kuadrit ligjor për donacionet është i domosdoshëm për të diferencuar burimet e tyre dhe për t'i kufizuar ato në masën e nevojshme, duke përcaktuar rregulla të qarta për shmangien e konfliktit të interesit.

Në sektorin e arsimit ndjekja e politikave kundër korrupsionit dhe forcimi i transparencës mbeten prioritet kryesor, për të garantuar integritetin dhe efikasitetin e institucioneve arsimore. Ndërkohë, sfidat e vazhdueshme, si: forcimi i mekanizmave të monitorimit, adresimi i nepotizmit, konfliktit të interesit dhe krijimi i platformave të qëndrueshme për raportim dhe transparencë kërkojnë qasje proaktive dhe ndërhyrje të thelluara.

Për sa i përket kapitullit të tetë “Parandalimi i financimeve të paligjshme dhe pastrimi i parave”, evidentohet se kuadri ligjor dhe institucional i Shqipërisë është pjesërisht i përafuar me standardet e BE-së, por ende kërkohet progres në disa drejtime kyçe për harmonizimin e plotë me *acquis*-në e BE-së. Një nga sfidat kryesore mbetet rritja e kapaciteteve për hetime financiare paralele me ato penale, të cilat shpesh nuk realizohen sistematikisht, duke kufizuar efektivitetin e sekuestrimeve dhe konfiskimeve të pasurive kriminale.

Një problematikë tjetër e rëndësishme lidhet me përdorimin e subjekteve tregtare në pasuritë e paluajtshme, si mjet për pastrimin e parave nga organizatat kriminale. Gjithashtu, është identifikuar përdorimi i kufizuar i teknikave të specializuara të hetimit financiar dhe mungesa e një qasje strategjike për adresimin e aseteve kriminale jashtë vendit. Sfidat institucionale dhe kapacitetet e kufizuara të burimeve njerëzore vazhdojnë të kufizojnë ndjekjen penale dhe konfiskimin efektiv të aseteve kriminale. Kontrolli për investimet e huaja direkte në sektorët strategjikë duhet të forcohet, për të parandaluar ndërhyrjet keqdashëse dhe për të mbrojtur interesat kombëtare. Paralelisht harmonizimi i kuadrit ligjor me standardet e BE-së për pastrimin e parave dhe financimet e terrorizmit mbetet një prioritet kryesor. Këto masa, të

kombinuara me ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, do të ndihmojnë në konsolidimin e përpjekjeve të Shqipërisë për t'i luftuar këto fenomene dhe për të siguruar një sistem ekonomik transparent dhe të mbrojtur.

Për sa i përket kapitullit të fundit “Rritja e ndërgjegjësimit dhe angazhimit shoqëror në luftën kundër korrupsionit”, nënvizohet se shoqëria civile luan një rol kyç në luftën kundër korrupsionit, por përfshirja e saj mbetet e kufizuar nga mungesa e burimeve financiare dhe teknike, si dhe nga mosreflektimi i sugjerimeve të saj në politikat publike. Gjithashtu, pjesëmarrja e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në proceset e konsultimit publik është e ulët, shpesh për shkak të mungesës së transparencës dhe vështirësive në aksesin ndaj informacionit. Ndërgjegjësimi dhe edukimi për korrupsionin, megjithëse janë pjesë e disa iniciativave dhe strategjive, mbeten të fragmentuara dhe të kufizuara në ndikimin e tyre. Përpjekjet për të edukuar qytetarët dhe të rinjtë për rëndësinë e integritetit janë të pamjaftueshme për të nxitur një ndryshim të qëndrueshëm në shoqëri. Me qëllim adresimin e problematikave është e domosdoshme që shoqëria civile të mbështetet me burime të qëndrueshme financiare dhe teknike, për të forcuar rolin e saj në monitorimin dhe parandalimin e korrupsionit. Përmirësimi i transparencës dhe aksesit në informacion është një tjetër prioritet, duke mundësuar që qytetarët dhe OSHC-të të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes dhe monitorimit të financave publike.

Edukimi kundër korrupsionit duhet të integrohet në kurrikulat shkollore dhe të bëhet pjesë e një strategjie të gjerë ndërgjegjësimi për të gjithë shoqërinë.

Së fundi, krijimi i qendrave kërkimore dhe zhvilluese, me fokus integritetin dhe mirëqeverisjen, do të ndihmonte në ndërtimin e një qasjeje të bazuar në të dhëna dhe bashkëpunim ndërsektorial, për të adresuar fenomenin e korrupsionit në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive.

▪ **Shtylla III: “Sundimi i ligjit”**

Dokumenti Analitik për shtyllën III “Sundimit të ligjit” organizohet në tri fusha tematike/kapituj: (i) “Funksionet e Kuvendit, roli mbikëqyrës dhe monitorues”; (ii) “Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave themelore të njeriut” (e drejta e pronës, e drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale, forcimi i institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut dhe edukimi ligjor i publikut); (iii) “Konsolidimi i reformës në drejtësi”. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të evidentuara në raportet e Komisionit Europian në lidhje me luftën kundër korrupsionit në Shqipëri, të ndara sipas kapitujve të analizës, përfshijnë:

Për sa i përket kapitullit të parë “Funksionet e Kuvendit, roli mbikëqyrës dhe monitorues së tij”, gjetjet dhe rekomandimet kryesore, të evidentuara edhe në raportet e Komisionit Europian fokusohen te këto çështje:

Duhet të zhvillohet më tej roli mbikëqyrës i Kuvendit mbi ekzekutivin. Në praktikë Parlamenti rrallë diskuton dhe vlerëson zbatimin e ligjeve dhe politikave qeveritare. Shqipëria duhet të rrisë mbikëqyrjen parlamentare ndaj qeverisë, në zbatim të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, dhe përmirësimin e rishikimeve e diskutimeve mbi raportet e auditimit të jashtëm. Shqyrtimi parlamentar i organeve të audituara, në zbatim të rekomandimeve, është ende i kufizuar dhe duhet të rritet përmes seancave më të shpeshta parlamentare dhe krijimit të një kuadri monitorues parlamentar, për të vlerësuar rregullisht veprimet vijuese të qeverisë. Rritja e përdorimit të procedurave të jashtëzakonshme kufizon mundësinë e shqyrtimit parlamentar mbi vendimmarrjen e qeverisë. Përdorimi i shpeshtë nga qeveria i akteve normative, që kanë fuqinë e ligjit për ndryshimin e buxhetit të shtetit, ngre shqetësime edhe në lidhje me

konsultimin publik, edhe transparencën, pasi këto akte janë të rezervuara për masa të përkohshme në rast nevojë dhe emergjente. Duhet të ndiqet rikthimi në proceset e rregullta të rishikimit të buxhetit përmes Kuvendit.

Polarizimi politik mbetet i lartë, gjë që vazhdon të ndikojë negativisht në funksionet kryesore legjislative dhe mbikëqyrëse të Kuvendit, duke zgjatur vonesat në emërimin e titullarëve në postet kyçe. Proceset e zgjedhjeve shpesh u nënshtrohen negociatave politike ose shtyhen për shumë muaj për shkak të mosmarrëveshjeve politike në Kuvend, duke vendosur në pikëpyetje autoritetin dhe pavarësinë e disa prej të emëruarve pas realizimit të këtij procesi. Kuvendi edhe një herë dështoi në emërimin e kryetarëve dhe anëtarëve të disa institucioneve, duke përfshirë Avokatin e Popullit (AP) dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD).

Mbikëqyrja parlamentare e punës së institucioneve të pavarura, pavarësisht se ndodh, mbetet disi një ushtrim burokratik, në pjesën më të madhe e kufizuar në shqyrtimin e raporteve të tyre vjetore. Kuvendi duhet të forcojë përpjekjet, në mbështetje të aktiviteteve të institucioneve publike të pavarura me rol mbikëqyrës; duhet të forcojë rolin e tij mbikëqyrës për punën e institucioneve të pavarura, duke përfshirë sigurimin e monitorimit sistematik të rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe ndjekjen e tyre. Nuk ka ende një afat kohor për të përmirësuar rregullsinë në raportim dhe bashkëpunim me Kuvendin.

Sa i përket ndikimit të punës së auditimit, niveli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm është ende i pamjaftueshëm, pavarësisht shkallës së lartë të rekomandimeve të pranura nga institucionet.

Përpjekjet mbeten të nevojshme për të trajtuar ndikimin e polarizimit politik në efektivitetin e Kuvendit. Zbatimi i kuadrit ligjor për proceset e konsultimit publik nga Kuvendi mbetet mjaft formal. Institucione të tilla, si: Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi mbështeten në platforma për konsultime publike të veçanta, me standarde të ndryshme të konsultimit publik. Masat për të inkurajuar pjesëmarrjen dhe ndërgjegjësimin e lartë nuk sigurojnë gjithmonë konsultime në kohë dhe ndjekjen e duhur të tyre, veçanërisht në lidhje me konsultimet për nismat legjislative të Kuvendit.

Ndërveprimi me OJQ-të/OSHC-të dhe grupet e interesit po ndodh por përgjithësisht në nivel formal, megjithëse mund të intensifikohet më tej dhe të zhvillohet në shkëmbime më kuptimplota. Mund të bëhen përpjekje të mëtejshme për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin, duke përfshirë ndërveprimet ndërmjet Kuvendit, OJQ-ve/OSHC-ve, si dhe publikimeve. Përmirësime të mëtejshme mbeten të nevojshme për të siguruar disponueshmërinë e dokumentacionit zyrtar parlamentar në kohë dhe në mënyrë miqësore për përdoruesit, për shoqërinë civile, medien, palët e tjera të interesuara dhe publikun e gjerë, këto përfshijnë në veçanti procesverbalet e seancave plenare dhe të mbledhjeve të komisioneve. Transparenca më e madhe dhe standardet më të larta etike në procedurat parlamentare janë ende të nevojshme, për t'u dhënë mundësi qytetarëve që të kenë lehtësisht akses në informacion rreth aktiviteteve të Kuvendit dhe për të nxitur një dialog politik më konstruktiv midis opozitës dhe shumicës. Duhet të amendohet legjislacioni për të përfshirë detyrimin që takimet e deputetëve dhe stafit të tyre me OSHC-të dhe lobistët të zhvillohen vetëm me ata që janë të regjistruar te regjistri i transparencës, në përputhje me dispozitat e vendimit të komisionit të datës 31 janar 2018 mbi Kodin e Sjelljes për anëtarët e Komisionit Europian. Përveç projektligjeve me ndikim buxhetor, nuk ka asnjë kërkesë ligjore për të siguruar që qeveria të shqyrtojë sistematikisht të gjitha projektligjet e iniciuara nga Kuvendi, gjë që mund të çojë në mospërputhje të legjislacionit dhe politikës.

Për sa i përket kapitullit të dytë “Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave themelore të njeriut”, në raportet e Komisionit Europian evidentohet se kuadri ligjor dhe institucional i Shqipërisë është

pjesërisht i përafruar me *acquis*-në e BE-së dhe standardet europiane për të drejtat themelore. Duhet të forcohet zbatimi për të garantuar gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut në praktikë, veçanërisht në lidhje me forcimin e kapaciteteve të institucioneve të pavarura të të drejtave themelore, mbrojtjen e të dhënave personale, mosdiskriminimin, si dhe përfundimin e proceseve kalimtare në fushën e të drejtave pronësore. Zbatimi duhet të forcohet për të garantuar gëzimin e të drejtave të njeriut në praktikë. Në këtë drejtim përpjekjet për të forcuar kapacitetin zbatues janë thelbësore tek të gjithë sektorët. Është e rëndësishme që të forcohen kapacitetet e organeve të pavarura të të drejtave të njeriut, duke përfshirë: Avokatin e Popullit, KMD-në dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP).

Duhet të adresohen bllokimet dhe vonesat në procedurën e emërimeve parlamentare të titullarëve të institucioneve të pavarura. Emërimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat, që sigurojnë në masën më të lartë të mundshme autoritetin, paanshmërinë, pavarësinë dhe legjitimitetin e institucioneve. Zbatimi efektiv i të drejtave të njeriut është sfidues, veçanërisht për të drejtën e pronës. Mungesat e stafit vazhdojnë të ndikojnë në funksionimin e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit. Ky institucion duhet të miratojë dhe të publikojë raportin vjetor përpara paraqitjes në Kuvend; duhet të forcohet zbatimi i rekomandimeve të AP-së; Kuvendi duhet të forcojë bashkëpunimin me AP-në dhe të trajtojë problemin e mungesës së reagimit të organeve të administratës publike, për më tepër, për të garantuar fuqi mbikëqyrëse efektive, mandati i AP-së duhet të mbulojë të gjithë ekzekutivin.

Kuadri i ardhshëm legjislativ për aksesin tek informacioni publik duhet të forcojë kompetencat e KDIMDP-së, duke ofruar mekanizmat për të zbatuar vendimet dhe mandatin për të kryer inspektime gjithëpërfshirëse. Po kështu, roli i koordinatorëve për të drejtën e informimit brenda autoriteteve publike duhet të forcohet. Ligji duhet të sigurojë autonominë organizative të KDIMDP-së dhe ta fuqizojë atë për të miratuar vendime detyruese.

Për sa i përket zbatimit, duhet të rriten kapacitetet dhe kompetencat e KDIMDP-së, nëse kërkohet që ai të trajtojë në mënyrë efektive përgjegjësitë e reja që rrjedhin nga ligji i ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Ndërgjegjësimi për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, si një e drejtë themelore, është ende në nivel të ulët tek institucionet publike, si dhe te publiku i gjerë. Shqetësim mbetet trajtimi i të dhënave personale nga kompanitë private dhe administrata publike, si dhe dobësitë e sistemeve qeveritare të IT-së. Nevojiten masa mbrojtëse të forta për të parandaluar shkeljet e të dhënave personale. Nevojiten veprime të mtejshme për të rritur ndërgjegjësimin e publikut rreth rreziqeve të mundshme dhe rritjes së kapaciteteve parandaluese të institucioneve publike. Zbatimi i rekomandimeve të KDIMDP-së është i ulët.

Kuadri ligjor dhe institucional për mosdiskriminimin mbetet pjesërisht i harmonizuar me *acquis*-në e BE-së dhe standardet europiane, duke përfshirë luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë.

KMD-ja ka vijuar të ushtrojë mandatin e tij në mënyrë të kënaqshme, por nivelet e burimeve njerëzore të tij mbeten të pamjaftueshme dhe duhet të sigurohen. Nevojiten kapacitete më të mira zbatuese dhe ndërgjegjësim më i madh, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta.

Referuar të drejtave të pronësisë, duhet të sigurohet përafrimi i plotë i kuadrit të saj legjislativ me standardet europiane dhe të zbatohen rekomandimet e Këshillit të Europës dhe vendimet e GJEDNJ-së në këtë fushë. Vitin e ardhshëm Shqipëria duhet të vijoje mbrojtjen e të drejtës së pronës, në veçanti, duke bërë progres vendimtar në regjistrimin e parë dhe kompensimin, duke përmirësuar transparencën e kadastrës shtetërore dhe cilësinë e të dhënave kadastrale të regjistrit të pronave, duke siguruar zbatimin e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të drejtës

për efektivitet të kompensimit në rastet e shpronësimit dhe heqjes së pronësisë. Duhet të zbatohet ligji për kadastrën dhe ligji për finalizimin e proceseve të pronësisë kalimtare. Nevojiten më shumë përpjekje për të finalizuar proceset kalimtare të pronësisë, regjistrimet e para të pronave dhe kompensimet e ligjshme për pronat e shpronësuara në mënyrë të paligjshme gjatë komunizmit. Shqipëria duhet të sigurojë që skema e kompensimit të zbatohet në mënyrë efektive.

Sa i përket Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), duhet të shtohen përpjekjet për të arritur objektivin e një procedure të finalizuar deri në vitin 2028; duhet të krijohet një sistem efikas dhe transparent i regjistrimit të pronës dhe menaxhimit të integruar, i cili ofron tituj të qartë dhe të sigurt pronësie për të siguruar të drejtën e pronës në praktikë. Të gjitha të dhënat kadastrale, duke përfshirë titujt e pronësisë dhe hartat kadastrale, duhet të digjitalizohen dhe përditësohen me kujdes, për të hequr sistematikisht të dhënat e mbivendosura ose të pasakta.

Puna e ASHK-së pengohet nga qarkullimi i lartë i punonjësve, përfshirë edhe postet drejtuese. Transparenca dhe cilësia e regjistrimit të pronave duhet të përmirësohet. Agjencia e Trajtimit të Pronave dhe ASHK-ja duhet të pajisen me mjete financiare dhe kapacitete njerëzore për të përmbushur mandatin e tyre. Shqipëria duhet të përfundojë proceset e tranzicionit në fushën e të drejtave pronësore me dokumente strategjike brenda afateve ligjore. Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin e plotë të vendimeve gjyqësore në fushën e të drejtave pronësore, përfshirë ato të GJEDNJ-së, si çështje prioritare. Shqipëria duhet t'i sqarojë ende mjetet juridike ekzistuese për shpronësimin dhe prishjen e paligjshme, si dhe të sqarojë kohëzgjatjen e dhënies së kompensimit në rastet e shpronësimit. Në Shqipëri ka shumë çështje gjyqësore të pazgjidhura lidhur me shpronësimin e pronave private. Të gjitha kufizimet në pronën private duhet të zbatohen në përputhje me standardet e KEDNJ-së.

Për sa i përket kapitulli të tretë “Konsolidimi i sistemit të drejtësisë”, puna nuk iu nënshtrohet të njëjta afateve që u ndoqën për komponentet e të tria shtyllave. Procesi u vonua paksa në kohë me qëllim përfshirjen e aktiveve të aktorëve të sistemit të drejtësisë dhe partnerëve ndërkombëtarë, por dhe për shkak të faktit se ky moment përkoi me periudhën e fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe KPP gjykoj ta shmangë riskun e përfshirjes së kësaj teme në debatin elektorale të partive politike.

Gjithsesi GENL vazhdoi punën për analizën e komponentit të konsolidimit dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë, duke ndjekur të njëjtën metodologji për sa i përket një analize që duhet bërë nga Kuvendi, ose *postlegislation scrutiny*, në zbatim të kuadrit ligjor të reformës në drejtësi në kuadër edhe të rekomandimeve të raporteve të Komisionit Europian, si dhe piketat hyrëse dhe të ndërmjetme të pozicionit të përbashkët të BE-së për Grup-kapitullin I “Themeloret”. Qëllimi i kësaj procesi ishte të konsolidojë arritjet pozitive të reformës në drejtësi si dhe të adresojë “dobësitë/mangësitë” e konstatuara. Në këtë drejtim, u ndoq e njëjta metodologji edhe në përgatitjen e kësaj analize, sikurse për shtyllat e tjera, duke përfshirë edhe institucionet e drejtësisë, të cilat kanë sjellë komentet dhe sugjerimet e tyre.

Nga të gjitha institucionet e drejtësisë është vlerësuar domosdoshmëria e kësaj ndërhyrjeje për të adresuar edhe problematikat e trajtuara prej tyre, si dhe është garantuar mbështetja e tyre ndaj punës së ekspertëve të GENL-së përmes analizave, studimeve e propozimeve të ndryshme që disponojnë, si dhe pranisë së ekspertëve të tyre në diskutimin e çështjeve që lidhen me fushatën e tyre të përgjegjësisë.

Gjatë veprimtarisë së KPP-së në këtë kapitull ka pasur vetëm një aspekt, për të cilin ka pasur qasje të ndryshme në komunikimin midis KPP-së dhe institucioneve të drejtësisë. KPP-ja ju ka propozuar që institucionet e drejtësisë të caktonin vet ekspertët dhe përfaqësuesit e tyre dhe një grup i formuar vetëm prej tyre të kryenin analizën postlegjislative, vlerësimin e propozimeve të tyre për ndryshime në kuadrin ligjor aktual, si dhe reflektimin në masa konkrete për përmbushjen e detyrimeve në kuadrin e procesit të negociatave, që lidhen me sistemin e drejtësisë. Nga komunikimi, një pjesë e institucioneve nuk ishin të gatshme për t'u përfshirë me ekspertët e tyre në këtë proces, disa edhe për shkak të ngarkesës në punë, duke kërkuar që kjo analizë të kryhet nga vetë Kuvendi dhe përfshirja e tyre të konsistonte në dërgimin e dokumenteve, komenteve dhe sugjerimeve. Meqenëse nuk kishte një qasje të njëjtë të të gjitha institucioneve për këtë propozim, u vijua me procesin normal që zhvillon Kuvendi bazuar në Rregulloren e tij.

Shtyrja në kohë lidhur me kapitullin e tretë lidhet, ndër tjera, edhe me faktin se KPP-ja nuk dëshironte që ky proces të lidhej me procesin zgjedhor të zgjedhjeve të përgjithshme që u zhvillua gjatë këtij 6-mujori në Shqipëri. Ndaj u vendos shtyrja në kohë e punës për këtë kapitull në një periudhë më të qetë politike e parlamentare, për të siguruar edhe një përfshirje më aktive të vetë institucioneve të drejtësisë.

Në thelb ky proces për kapitullin e tretë “Konsolidimi i reformës në drejtësi” synon:

- i) Reflektimin e detyrave të Kuvendit brenda përgjegjësiave dhe hapësirave të tij kushtetuese në këtë fushë. Janë rreth 41 rekomandime nga BE-ja dhe 59 masa që përfshijnë Parlamentin, i cili do të duhet të reflektojë me angazhime e detyra konkrete. Një pjesë e tyre janë masa të parashikuara për realizim nga angazhimet në kuadrin e pozicionit negociues.
- ii) Forcimin e rolit kushtetues të Parlamentit në drejtim të mbikëqyrjes më efektive të institucioneve, përfshirë institucionet e drejtësisë, duke respektuar parashikimet aktuale kushtetuese. Raportet e BE-së evidentojnë se roli i Parlamentit në këtë drejtim duhet të përmirësohet. Gjithashtu, institucionet e drejtësisë kanë prezantuar propozime për përmirësimin e këtij procesi.
- iii) Së shpejti mbushen rreth 10 vjet nga miratimi i paketës kushtetuese e ligjore të reformës në drejtësi dhe gjykohet se, siç ndodh në çdo proces parlamentar normal, të kryhet një kontroll postlegjislativ i këtij legjislacioni. Gjithashtu, institucionet e drejtësisë kanë kërkuar ndryshime të legjislacionit të reformës në drejtësi, duke propozuar në Kuvend rreth 150 amendamente për ndryshime të kuadrit legjislativ të reformës në drejtësi. Vlerësimi dhe reflektimi i tyre pa dyshim kërkon një analizë të thelluar, duke mbajtur në konsideratë dhe zbatuar rekomandimet e Komisionit European.

VI. Raporti i vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore

Projektakti në vetvete nuk parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit.

PROPOZUES

Deputetët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin European”

DOKUMENT PARLAMENTAR